



**BASHKIA
TIRANË**

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 84, datë 26.07.2017

PËR

**“NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 59, DATË 30.12.2015 TË KËSHILLIT BASHKIAK
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS”
TË NDRYSHUAR”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja (b) dhe pika 1.3, nenit 35, shkronja (c), nenit 54, shkronja (k) dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 113 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 5, shkronja (ç), pika (iv), nenit 9, pika 4 dhe nenit 26 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, vendimit nr. 32, datë 13.06.2016 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2016, nga granti “Shqipëria dixhitale”, Programi “Shqipëria Dixhitale”, shtylla III, e fondit të zhvillimit të rajoneve”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Në pikën 1, shkronja (c) të vendimit nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” i ndryshuar, shtohet paragrafi si më poshtë vijon:
“Mënyra e deklarimit dhe raportimit për operatorët ekonomikë që janë subjekt i taksës së fjetjes në hotel, do të bëhet nëpërmjet sistemit elektronik të qendëruar të ngritur nga Bashkia Tiranë”.
2. Ngarkohen Drejtoria e Sistemeve të Informimit dhe IT-së, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI